UDHËZIM
Nr.12, datë 20.8.2008

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR.4162, DATË 18.10.1999 "MBI KONTROLLIN SHTETËROR DHE MBIKËQYRJEN E KUALIFIKUAR NË TRANSPORTIN RRUGOR"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenit 67 të kreut VI të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

1. Pas paragrafit të parë të nenit 1 shtohet një paragraf me përmbajtjen si vijon:

"Personat që kryejnë detyrën e kontrollorit të vazhdueshëm shtetëror, të specializuar në rrugë, pajisjen me uniformë (me shenja dalluese), me dokument identifikimi, me tabela të ndalimit të automjeteve dhe me pajisje teknike e logjistike, të domosdoshme e të nevojshme për kryerjen e detyrës. Caktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës dhe të pajisjeve teknike e logjistike caktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi